



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO  
**GJYKATA KUSHTETUESE**  
**УСТАВНИ СУД**  
**CONSTITUTIONAL COURT**

---

Prishtinë, më 16 janar 2013  
Nr. ref.:RK347/13

## **AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI**

në

**Rastin nr. KI76/12**

Parashtruesi

**Qamil Xhemajli**

**Vlerësim i kushtetutshmërisë së vendimit të paspecifikuar të Qeverisë së Republikës së Kosovës në lidhje me pensionimin e doktorëve të shkencës në Universitetin e Prishtinës**

**GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS**

e përbërë nga:

Enver Hasani, Kryetar  
Ivan Čukalović, Zëvendëskryetar  
Altay Suroy, gjyqtar  
Almira Rodrigues, gjyqtar  
Snezhana Botusharova, gjyqtare  
Kadri Kryeziu, gjyqtar dhe  
Arta Rama-Hajrizi, gjyqtare.

### **Parashtruesi i kërkesës**

1. Parashtruesi i kërkesës është Qamil Xhemajli nga Komuna e Pejës.

## **Vendimi i kontestuar**

2. Vendimi i paspecifikuar i Qeverisë së Republikës së Kosovës në lidhje me pensionimin e doktorëve të shkencës të cilët punojnë në Universitetin e Prishtinës (në tekstin e mëtejme: U.P.) sipas të cilit ata kanë të drejtë në një pension prej 1000 €, të cilin parashtruesi i kërkesës nuk e ka specifikuar me numër, datë ose në një mënyrë tjetër, dhe as që ka cekur se ku është publikuar ky vendim, kështu që ai nuk ka cekur as përmbajtjen e vendimit të cilin e konsideron antikushtetues.

## **Objekti i çështjes**

3. Objekti i çështjes janë të drejtat të cilat parashtruesi i kërkesës konsideron se i takojnë në bazë të vendimit të paspecifikuar të Qeverisë së Republikës së Kosovës në lidhje me pensionimin e doktorëve të shkencës të cilët punojnë në U.P, për çka parashtruesi i kërkesës konsideron se të njëjtat të drejta duhet t'i takojnë edhe doktorëve të tjerë të cilët nuk kanë punuar në U.P. ose të cilët nuk kishin doktoruar në U.P.

## **Baza juridike**

4. Kërkesa është bazuar në nenet 113.7 dhe 21.4 të Kushtetutës, në nenet 20, 22.7 dhe 22.8 të Ligjit nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës të 15 janarit 2009 (në tekstin e mëtejme: „Ligji“) dhe në rregullin 56. paragrafi 2. të Rregullores.

## **Procedura në Gjykatë**

5. Parashtruesi i kërkesës më 16 gusht 2012, i parashtroi një kërkesë Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: „Gjykata“).
6. Më 17. gusht 2012. Gjykata Kushtetuese e informoi parashtruesin e kërkesës që kërkesën e tij ta plotësojë në formularin i cili është i përcaktuar nga ana e Gjykatës dhe në të njëjtën kohë të dorëzojë vendimin e Qeverisë të cilin e konsideron antikushtetues, si dhe dëshmitë se me këtë vendim janë shkelur të drejtat të tij kushtetuese.
7. Parashtruesi i kërkesës më 23 gusht 2012, paraqiti një formular të plotësuar për paraqitjen e kërkesës, por jo edhe vendimin e Qeverisë të cilin e konsideron antikushtetues.
8. Me vendimin e presidentit (nr. GJR. 76/12 të 04 shtatorit 2012), gjykatësi Ivan Čukalović u emërua si Gjyqtar Raportues. Të njëjtën ditë, me vendimin e presidentit nr. KSH. 76/12 u emërua Kolegji shqyrtues i përbërë nga gjyqtaret: Almiro Rodrigues (kryetar), Snezhana Botusharova dhe Kadri Kryeziu.
9. Më 23 nëntor 2012, pas shqyrtimit të raportit të Gjyqtarit raportues Ivan Čukalović, Kolegji Shqyrtues i përbërë nga gjyqtarët: : Almiro Rodrigues (kryetar), Snezhana Botusharova dhe Kadri Kryeziu, i rekomanduan gjykatës në përbërje të plotë për papranueshmërinë e kërkesës.

## **Përmbledhja e fakteve**

10. Parashtruesi i kërkesës është Dr. i shkencës së agroekonomisë i cili ka doktoruar në Universitetin e Beogradit më 2 korrik 1986.

11. Parashtruesi i kërkesës më 19 qershor 2012 i paraqiti një ankesë Avokatit të Popullit në lidhje me vendimet të Qeverisë së Republikës së Kosovës në lidhje me pensionimin e doktorëve të shkencës të cilët punojnë në U.P.

12. Institucioni i Avokatit të Popullit më 30 qershor 2012 i dërgoi parashtruesit të kërkesës njoftim për papranueshmërinë në të cilin ndër të tjera cek:

*“Megenëse nga dëshmitë e paraqitura dhe rrethanat e përshkruara në ankesë tuaj rezulton se proceduarat, lidhur me lëndën tuaj janë duke u zhvilluar në organet kompetente, Avokati i Popullit, në pajtim me nenin 20, pika 1.3 të Ligjit për Avokatin e Popullit, ka vendosur ta refuzojë ankesën tuaj si pabazuar..“*

13. Parashtruesi i kërkesës nuk ka ofruar dëshmi të tjera të cilat do të ishin të rëndësishme për vendimin të Gjykatës edhe pse Gjykata ka kërkuar me shkrim prej parashtruesit të kërkesës ta dërgojë vendimin e Qeverisë të cilin e konsideron antikushtetues.

#### **Pretendimet e parashtruesit të kërkesës**

14. Parashtruesi i kërkesës pretendon si në vijim:

*“Ankesa e ime ka të bëjë me Vendimin e Qeverisë së RK lidhur me pensionimin e dr. Të shkencave nga UP me pensionimin mujor prej 1000 € në muaj. Ky Vendim është publikuar nga RTK. Nga organet kompetent kam kërkuar Vendimin në fjalë, por nuk kam marr kurrfarë përgjigje!”*

*“Nga z. Kryeministri dhe Ministri i Drejtësisë z. H. Kuqi më 8. 07. 2012. kam kërkuar që ky Vendim të plotësohet edhe për shkencëtarë që kanë kontribuar në ekonominë Kosovare, por përgjigjja si zakonisht ka munguar!.”*

15. Parashtruesi me tej konsideron që:

*“...me këtë Vendim seleksionues është bërë shkelja e Ligjeve, sepse me të gjitha diplomat e Universitetit (Zagrebit dhe Beogradit) shkruan së „doktorit të shkencave u TAKOJNË të gjitha të drejtat të parapara me ligj“.*

*“Ky Vendim është selektues, ofendues, antiligjor dhe antikushtetues sepse doktorët e shkencave i ndan në dy grupe: a) ata të merituar dhe b) në ata ma pak të merituar që është absurd pa presedanë.”*

16. Parashtruesit e kërkesës i drejtohen Gjykatës Kushtetuese me një kërkesë si në vijim:

*“Kërkoj nga Gjykata juaj që vendimin e Qeverisë së Kosovës të shpalle antikushtetues.”*

*“Deklaroj së në vitin 1996 jam pensionuar me dhunë dhe mu ka dashtë të pres 12 vite gjersa i kom plotësuar kushtet e pensionit të pleqërisë.”*

*“Jam në moshë të shtyre (74 vite) dhe lëngoje prej shume sëmundjeve të pa shëruara dhe kam pak gjasa të shfrytëzojë këtë të drejtë ligjore.”*

## Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës

17. Në mënyre që Gjykata të mund të gjykojë kërkesën e parashtruesit, së pari duhet të vlerëson nëse parashtruesi i ka plotësuar kushtet e pranueshmërisë të parapara me Kushtetutën dhe Ligjin, si dhe me Rregulloren e Punës.
18. Në lidhje me këtë, Gjykata i referohet nenit 113. paragrafët 1 dhe 7 të Kushtetutës:

*“1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.”*

*“7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuar me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shterur të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj.”*
19. Neni 48 i Ligjit për Gjykatën Kushtetuese parasheh:

*“Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejtat dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron të kontestoj.”*
20. Përveç kësaj, rregulli 36 (2) (d) parashikon:

*“2. Gjykata do të refuzojë një kërkesë si qartazi të pabazuar nëse bindet se:  
“d) kur parashtruesi nuk dëshmon në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij.”*
21. Parashtruesi nuk ka paraqitur asnjë dëshmi *prima facie*, e cila tregon që ka pasur shkelje të drejtave të tij kushtetuese (shih, Vanek kundër Republikës së Sllovakisë, Vendimi KEDLJ në lidhje me pranueshmërinë e kërkesës, nr. 53363/99 i 31 majit 2005).
22. Parashtruesi i kërkesës pretendon se i ja në shkelur të drejtat me Vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës në lidhje me pensionimin e doktorëve të shkencës të cilit punojnë në Universitetin e Prishtinës, duke mos paraqitur këtë Vendim me të cilin parashtruesit të kërkesës i janë shkelur të drejtat e tij kushtetuese.
23. Në fund, kushtet për pranueshmërinë nuk janë plotësuar në këtë parashtrësë. Parashtruesi i kërkesës nuk ka arritur të cekë dhe mbështet me dëshmi me cilin Vendim të Qeverisë së Republikës së Kosovës gjoja ju kanë shkelur drejtat dhe liritë e tij të kushtetuese, sepse të njëjtën nuk e ka paraqitur krahas me kërkesën e Gjykatës Kushtetuese.
24. Nga kjo del se kërkesa është qartazi e pabazuar në pajtim me rregullin 36 (2d) të Rregullores së punës e cila parasheh „Gjykata do të refuzojë një kërkesë si qartazi të pabazuar nëse bindet se: d) kur parashtruesi nuk dëshmon në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij.“

## PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, nenit 46, nenet 47 dhe 48 të Ligjit dhe rregullit 36 (2d) të rregullores së Punës, në seancën e mbajtur më 23 nëntor 2012, njëzëri

## VENDOSI

- I. TA HEDHË POSHTË kërkesën si të papranueshme;
- II. Ky Vendim do t'u komunikohet palëve dhe do të publikohet në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20(4) të Ligjit; dhe
- III. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportuese

Kryetari i Gjykatës Kushtetuese

Ivan Čukalović



Prof. dr. Enver Hasani

